



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/ 2018

V E N D I M

Nr. 76 , Datë 19 / 03 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me Nr. Regj. 106, datë 21.10.2016, të z.D. D, kundër subjektit Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Z.D. D shprehet se në vitin shkollor 2012 ka mbaruar studimet në shkollën e mesme, në shtetin e Belgjikës. Me shkresën me nr.1/206 prot., datë 01.08.2016 ka dorëzuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit¹ dokumentacionin përkatës për vijimin e procedurave për njëvlefshmërinë e diplomës së arsimit parauniversitar, në Republikën e Shqipërisë.

Me shkresën me nr.1/206/1 prot., datë 24.08.2016, Komisioni i Posaçëm në MAS, ingritur me Urdhër nr.165, datë 08.04.2016 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për procedurat e njëvlefshmërisë së dëftesave/diplomave të shkollave të mesme të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit”, ka nxjerrë dokumentin e njëvlefshmërisë së dëftesës/diplomës së shkollës së mesme për procedura të mëtejshme nga AKP-ja.

Subjekti ankues pretendon se është diskriminuar nga ana e MAS, pasi argumenton se nuk është vlerësuar me objektivitet nga ana e këtij Komisioni, duke u vlerësuar me më pak pikë se sa kishte në diplomën origjinale, të marrë në shtetin belg. Po ashtu ankuesi, pretendon se vlerësimi i Gjuhës Shqipe me 5 pikë është i paqartë për të. Si është arritur në këtë përfundim, kur atij nuk i është kërkuar asnjë dokument ku të vërtetohej shkalla e njohurive të tij në gjuhën shqipe, apo të kishte një vlerësim të tillë?!

Lidhur me këtë ankuesi sjell si provë dokumentin ku rezulton të jetë bërë, shënuar njësimi i pikëve. Kështu, referuar këtij dokumenti rezulton se:

Nota mesatare e viteve të shkollimit është 6.7 (gjashtë pikë shtatë)

Nota mesatare e provimeve të maturës: 7.7 (shtatë pikë shtatë).

Nota D₁: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe: 5 (pesë).

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën MAS.

Nota D₂: Matematikë: 10 (dhjetë).

Nota D₃: Gjuhë e huaj: 6.4 (gjashtë pikë katër).

Nota Z₁: Psikologji: 8.5 (tetë pikë pesë).

Nota Z₂: Biologji e Thelluar: 8.5 (tetë pikë pesë).

Nota mesatare e përgjithshme: 7.2 (shtatë pikë dy).

Po ashtu, z.D pretendon se duhet të ishte përfshirë në listën e studentëve që përfitojnë nga kuotat për të huajt.

Ankuesi kërkon nga ana e Komisionerit që në zbatim të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, t’i rekomandojë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit rivlerësimin e diplomës së tij, duke konkluduar me një mesatare më të lartë nga ajo që është përlogaritur nga Komisioni i Posaçëm në MAS, mesataren që ankuesi pretendon se kishte në diplomën origjinale të shkollës së shtetit belg.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, **përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër**”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën Nr.961/1 prot, datë 28.10.2016 u njoftua dhe ju kërkua informacion subjektit Ministria e Arsimit dhe e Sportit, lidhur me pretendimin e z.D.
2. Në mungesë të përgjigjes nga ana e MAS, me datë 16.12.2016², Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim në ambjentet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Inspektorët e KMD-së u takuan me Përgjegjësin e Sektorit të Arsimit të Mesëm, z.D. S, pranë kësaj ministrie. Z.S, për shkak se ishte njohur me vonesë me Urdhërin e inspektimit të Komisionerit, kërkoi një afat për përgatitjen e përgjigjes dhe dërgimin e saj deri më datë 06.01.2017. Ai informoi Komisionerin se z.D. D nuk kishte paraqitur asnjë ankuesë pranë MAS

²Në zbatim të Urdhërit nr. 2, datë 08.01.2015, të Komisionerit.

lidhur me pretendimin e tij për rivlerësim të diplomës së tij dhe se ishin të gatshëm që të bënin një rivlerësim të dytë, me kërkesë të ankuesit, konform ligjit dhe rregulloreve në fuqi.

- Me shkresën me nr.12332/1 prot., datë 06.01.2017 MAS informon Komisionerin se:
- *“Njëvlefshmëria e dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar, të ardhur nga jashtë vendit, realizohet në mbështetje të Udhëzimit nr.44, datë 21.08.2013 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurës të njëvlefshmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”.*
 - *Dokumentacioni shkollor i paraqitur nga z.D. D, është shqyrtuar nga Komisioni i Posaçëm, i ngritur me urdhër të Ministrit.*
 - *Z.D ka dorëzuar dokumentacionin pranë MAS me datë 01.08.2016, protokolluar me nr.1/206 prot. dhe është njëvlerësuar me shkresën me nr.1/2016/1 prot., tërhequr nga ai me datë 24.08.2016.*
 - *Në këtë procedurë z.D. D është paraqitur para Komisionit si shtetas shqiptarë, bazuar në dokumentin e identifikimit të paraqitur nga vetë i interesuari.*
 - *Lidhur me pretendimin se z.D nuk ka zhvilluar gjuhën shqipe, dhe për këtë është vlerësuar me notën 5 (pesë), sqarojmë se, Komisioni, në njëvlerëshmërinë e dokumentacionit shkollor të shtetasve shqiptarë/të huaj, që vijnë nga jashtë vendit për të aplikuar në IAL-të, gjuhën zyrtare të shkollimit të shtetit nga ai vjen, e njehson me gjuhën shqipe dhe letërsinë.*
 - *Arritjet shkollore që rezultojnë nga dokumentet e shkollimit të lëshuara nga institucionet shkollore të origjinës, njehsohen sipas tabelës së konvertimit për sistemin e vlerësimit në institucionet arsimore në Republikën e Shqipërisë.*
 - *Z.D. D nuk ka paraqitur asnjë ankesë apo kërkesë zyrtare pranë Komisionit për rishqyrtim apo rivlerësim të dokumentacionit të tij shkollor”.*

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes së z.D, Komisioneri me datë 23.01.2017 realizoi një seancë dëgjimore mes palëve³.

Ministria e Arsimit dhe Sportit u përfaqësua në seancën dëgjimore nga Juristja e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, znj.A. V, si person i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm, për të përfaqësuar këtë Institucion, me shkresën me nr. 461/1 prot., datë 23.01.2017. Znj.V kërkoi një afat dy javor të dërgonte informacionin e kërkuar nga Komisioneri.

Subjekti ankues, z.D njoftoi Komisionerin përpara zhvillimit të seancës dëgjimore se nuk mund të merrte pjesë, për shkak se ndiqte procesin mësimor në një nga Universitetet Private.

³Në zbatim të Njoftimit me nr.39 prot., datë 18.01.2017, të Komisionerit.

4. Lidhur me plotësimin e informacionit të kërkuar gjatë seancës dëgjimore të datës 23.01.2017, me e-mailin e datës 06.02.2017, MAS dërgoi në adresë të KMD-së informacionin dhe bashkëngjitur dokumentet provuese⁴.

Pas vlerësimit të fakteve dhe provave të grumbulluara gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri vlerëson se:

I. Lidhur me pretendimin e z.D se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe jo objektive, në procedurën e njëvlershmërisë së diplomës, nga ana e Komisionit të Posaçëm.

Subjekti ankues argumenton se nuk është vlerësuar me objektivitet nga ana e këtij Komisioni, duke u vlerësuar me më pak pikë se sa kishte në diplomën origjinale, të marrë në shtetin belg. Po ashtu ankuesi, pretendon se vlerësimi i Gjuhës Shqipe me 5 pikë është i paqartë për të. Lidhur me këtë ankuesi sjell si provë dokumentin ku rezulton të jetë bërë, shënuar njësimi i pikëve⁵.

Ankuesi kërkon nga ana e Komisionerit që në zbatim të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, t’i rekomandojë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit rivlerësimin e diplomës së tij, duke konkluduar me një mesatare më të lartë nga ajo që është përlllogaritur nga Komisioni i Posaçëm në MAS, mesataren që ankuesi pretendon se kishte në diplomën origjinale të shkollës së shtetit belg.

II. Lidhur me shkakun e pretenduar nga ankuesi (përkatësia në një grup të veçantë), si shkak të sjelljes të pafavorshme ndaj tij.

Për të vërtetuar se ndaj ankuesit ka një sjellje diskriminuese nga ana e MAS, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁶ dhe trajtimin të pafavorshëm të ankuesit.

⁴ Depozituar si provë në dosjen e ankuesit.

⁵ Kështu, referuar këtij dokumenti rezulton se:

- Nota mesatare e viteve të shkollimit është 6.7 (gjashtë pikë shtatë)
- Nota mesatare e provimeve të maturës: 7.7 (shtatë pikë shtatë).
- Nota D₁: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe: 5 (pesë).
- Nota D₂: Matematikë: 10 (dhjetë).
- Nota D₃: Gjuhë e huaj: 6.4 (gjashtë pikë katër).
- Nota Z₁: Psikologji: 8.5 (tetë pikë pesë).
- Nota Z₂: Biologji e Thelluar: 8.5 (tetë pikë pesë).
- Nota mesatare e përgjithshme: 7.2 (shtatë pikë dy).

⁶ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, në atë të studentëve që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në një shtet të huaj dhe që duan të njëvlerësojnë diplomat e tyre në RSH, në mënyrë që të ndjekin IAL-të në RSH.

Lidhur me këtë:

- Diploma e shkollës së mesme të lartë, lëshuar nga shteti belg, vërteton se ai ka mbaruar studimet në këtë shtet.
- Dokumenti me nr.1/206/1 prot., datë 24.08.2016 i MAS, vërteton se z.D. D i është njëvlerësuar diploma e shkollë së mesme për procedura të mëtejshme për ndjekjen e IAL-ve në RSH.
- Pra, vërtetohet se ankuesi ka mbaruar studimet e mesme të larta në shtetin belg dhe ky dokument është i vlefshëm dhe njihet dhe nga institucionet e RSH-së. Ai i përket grupit të studentëve që kanë përfunduar arsimin të mesëm të lartë jashtë vendit dhe do të regjistrohet për ndjekjen e IAL-ve në RSH.
- Neni 1, i LMD-së i parashikon përkatësinë në një grup të veçantë, si shkak të mbrojtur prej tij.

Komisioneri vlerëson se lidhur me këtë shkak ankuesi legjitimohet për ta trajtuar çështjen e tij pranë KMD-së.

III. Lidhur me provat dhe argumentimin e MAS lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim.

Njëvlershmëria e dëftesave dhe diplomave të arsimit të nxënësve të arsimit parauniversitar, të ardhur nga jashtë vendit, realizohet në mbështetje të Udhëzimit nr.44, datë 21.08.2013 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”.

Lidhur me sa më lart, në zbatim të pikës 1, Kreu 3, të këtij udhëzimi, me urdhër të Ministrit është ngritur Komisioni i Posaçëm, për kryerjen e procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit.

Pika 2, e po këtij kreu, përcakton se: “*Dokumentet për njëvlershmërinë për ndjekjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë janë:*

- A. Formulari i aplikimit për njëvlershmëri.
- B. Kopja e dokumentit të identifikimit të personit të interesuar.
- C. Kopja e përkthyer dhe e noterizuar e dëftesave dhe e diplomës që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë jashtë vendit ose, në mungesë të dëftesave, kopja e përkthyer dhe e noterizuar e listës së notave të arsimit të mesëm të lartë.
- D. Dokumenti që vërteton se shkolla e kryer jashtë vendit lejon studime universitare në atë vend.

E. Çertifikata e zotërimit të gjuhës shqipe lëshuar nga Universiteti i Tiranës.

Përrjashtohen nga ky detyrim shtetasit që:

- a) kanë përfunduar arsimin e detyruar në shkolla shqipfolëse;
- b) janë çertifikuar nga shkollat e mësimit plotësues të gjuhës shqipe në diasporë në nivelin e tretë”.

Komisioneri shqyrton ankesën në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, dhe bën verifikimet nëse në kundërshtim me këtë ligj kemi trajtim të ndryshëm në kushte të njëjta të ankuesit krahasuar me persona të tjerë, apo trajtim më pak të favorshëm të tij, krahasuar me parashikimet ligjore, për një nga shkaqet e parashikuara në LMD⁷.

Lidhur me sa më sipër, Udhëzimi ka përcaktuar qartazi kriteret që duhen plotësuar dhe procedurën që duhet ndjekur në procesin e njëvlershmërisë së diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit.

Në këtë kontekst, pretendimi i ankuesit se nuk është vlerësuar me objektivitet nga ana e Komisionit të Posaçëm⁸, sa i takon vlerësimin të tij lidhur me lëndën e gjuhës shqipe me notën pesë, lëndë të cilën ai nuk e ka zhvilluar; është plotësisht i drejtë dhe i bazuar, kjo për faktet që parashtrajmë:

1. Argumentimi i dhënë nga MAS lidhur me këtë pikë ishte se Komisioni, në njëvlershmërinë e dokumentacionit shkollor të shtetasve shqiptarë/të huaj, që vijnë nga jashtë vendit për të aplikuar në IAL-të, gjuhën zyrtare të shkollimit të shtetit nga ai vjen, e njehson me gjuhën shqipe dhe letërsinë.
2. Ndërkohë që theksojmë se, germa E), e pikës 2, të udhëzimit sipërcituar, ka përcaktuar qartë se çertifikata e zotërimit të gjuhës shqipe, lëshuar nga Universiteti i Tiranës është një nga dokumentet që aplikuesit duhet të plotësojnë/dorëzojnë pranë Komisionit për njëvlershmërinë e diplomës së tyre, për ndjekjen e IAL-ve në Republikën e Shqipërisë. Dhe se nga ky detyrim përjashtohen vetëm kategoritë e shtetasve, të specifikuara si më poshtë, që:
 - kanë përfunduar arsimin e detyruar në shkolla shqipfolëse;
 - janë çertifikuar nga shkollat e mësimit plotësues të gjuhës shqipe në diasporë në nivelin e tretë.
3. Komisioneri vlerëson si të pabazuar argumentin e MAS se Komisioni nuk e konsideron çertifikatën e gjuhës shqipe të Universitetit të Tiranës si dokument të domosdoshëm për njehsimin, pasi kjo nuk kërkohet dhe në formularin e aplikimit. Ky argument nuk qëndron, pasi vetë formulari është apo duhet të ishte hartuar në përmbushje të kërkesave të përcaktuara qartë në Udhëzimin nr.44/2013.

⁷Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

⁸Në vijim do t'i referohemi si Komisioni.

Lidhur me sa mësipër, rezulton se z.D nuk ka paraqitur asnjë dokument që ta përjashtonte atë nga detyrimi që ka përcaktuar germa E), e pikës 2, të këtij Udhëzimi⁹. Pra, rezulton se Komisioni është në shkelje të kësaj pike të Udhëzimit.

4. Nga ana tjetër, MAS në argumentimin e vet lidhur me vlerësimin e ankuesit me notën pesë për gjuhën shqipe dhe letërsinë, në një kohë kur ai nuk e ka zhvilluar këtë lëndë, i referohet “Tabelës së konvertimit për sistemin e vlerësimit në institucionet arsimore në RSH”. Lidhur me këtë fakt, Komisioneri vlerëson se ky argumentim është i pabazuar dhe nuk provohet, për arsyen se po t’i referohemi kësaj tablele, vërehet se aty janë përfshirë 18 shtete, numërtuar nga 1-18, ku citohen specifikisht: Greqia, Gjermania, Italia, Kosova, SH.B.A, Turqia, Luksemburgu, Austria, Bullgaria, Rumania, Finlanda, Polonia, Sllovenia, Danimarka, Norvegjia, Zvicra dhe Anglia. Pra, shihet qartë që Belgjika, shteti ku ankuesi ka përfunduar studimet parauniversitare nuk citohet fare dhe nuk është e përfshirë në këtë tabelë. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se Komisioni nuk justifikon faktin që ka vlerësuar me notën pesë gjuhën shqipe dhe letërsinë, duke iu referuar kësaj tablele.
5. Po ashtu, nga ana tjetër, MAS nuk justifikon as mënyrën se si është arritur në këtë vlerësim nga ana e Komisionit, pasi edhe pse është kërkuar nga Komisioneri, nuk ka sjellë asnjë provë, shkresë për ta provuar atë. Nga MAS është cituar se: *“Komisioni nuk mban një procesverbal të veçantë për çdo aplikant, por akti i njësimt/ekuivalentimit firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit, hartohet në tre kopje, njëra prej të cilave i jepet aplikuesit, njëra ruhet në protokollin e MAS, dhe tjetra në AKP. Komisioni, njëvlershmërinë e realizon sipas tabelës së konvertimit dhe vlerësimit sipas sistemeve arsimore të shteteve (pjesë e Udhëzimit nr.44/2013)”* .

Komisioneri, vlerëson se lidhur me faktin që gjatë procesit për ndjekjen e procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit, Komisioni duhet të mbajë një akt shkresor (procesverbal), i cili të jetë në përputhje me parashikimet e neneve 99 dhe 100¹⁰, të Kodit të Procedurës Administrative, duke qenë se ai është një akt administrativ, dhe si i tillë duhet që:

“ 1. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban:

- a) *Pjesën hyrëse që përmban:*
 - *Emrin e organit publik që nxjerr aktin;*
 - *palët të cilave u drejtohet akti;*
 - *datën e miratimit;*

⁹ Një dokument i tillë është pohuar edhe nga ana e MAS që nuk zotërohet prej tyre; dhe as nga subjekti ankues nuk është pohuar apo provuar që të ketë dorëzuar një dokument të tillë.

¹⁰ Neni 100, i P.pr.Ad. “...Arsyetimi i aktit administrative duhet të jetë i qartë dhe përmban:

- a) *shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;*
- b) *shpjegimin e përmbledhur të rezultatit...;*
- c) *bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast;*
- d) *në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar”.*

- bazën ligjore;
- pjesën arsyetuese;
- dispozitivin që tregon;
- pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;
- kohën e hyrjes në fuqi të aktit;
- të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit”.

Në periudhën Korrik-Gusht 2016 numri i aplikantëve (shtetas të huaj dhe shqiptarë), të cilët kanë kryer arsimin e mesëm të lartë, jashtë vendit dhe kanë aplikuar për në IAL-të në RSH, rezulton të jetë rreth 400 (katërqind).

Nga këqyrja dhe verifikimi i dokumentacionit të disa prej tyre¹¹ rezulton që për të gjithë është ndjekur dhe zbatuar e njëjta praktikë: pra sa i takon gjuhës shqipe dhe letërsisë, të gjithë janë vlerësuar duke iu referuar gjuhës amtare të vendit/shtetit ku ata kanë mbaruar arsimin e mesëm të lartë. Kështu, janë parë praktikat për aplikantët nga shtetet: Turqi, shtetasi G. T; Greqi, shtetasja A. C; Itali, shtetasi G. De S; Libi, shtetasi S. H. A. R.

Nga sa shihet si ankuesi, z.D, ashtu dhe të gjithë aplikantët e tjerë nuk janë trajtuar në mënyrë të pafavorshme sa i takon praktikës së ndjekur nga Komisioni, krahasuar me njëri-tjetrin; por janë trajtuar në mënyrë të pafavorshme në raport me parashikimet ligjore, specifikisht, në lidhje me zbatimin e germës E) të pikës 2, të kreut 3, të këtij Udhëzimi.

Neni 3, pika 2 i po këtij ligji, shpreh se: ““Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.

Në nenin 7 të ligjit nr. 10 221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Pra, z.D është trajtuar në mënyrë të pafavorshme lidhur me parashikimet e udhëzimit sipërcituar, gjë që në interpretim të nenit 3, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, e vë ankuesin në pozitat e diskriminimit të drejtpërdrejtë nga ana e Komisionit të Posaçëm, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

¹¹ Përzgjedhja e dosjeve për verifikim u bë në mënyrë rastësore, nga Komisioneri, gjatë inspektimit në MAS.

IV. Lidhur me pretendimin e ankuesit se duhet të ishte përfshirë tek kuotat për të huajt.

Për pretendimin se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme nga ana e MAS, sa i takon faktit se ai duhet të ishte përfshirë tek kuotat për të huajt, Komisioneri, konstaton se:

1. Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë MAS nga ana e z.D. D, rezulton se në përmbushje të pikës 5, të formularit të aplikantit dhe të germës b), pika 2, e kreut 3, të Udhëzimit nr.44/2013, është dorëzuar kopje e dokumentit të identifikimit të personit të interesuar, pra, z.D. D. Dokumenti mban datën 26.01.2015 dhe është lëshuar nga autoriteti përkatës, Ministria e Punëve të Brendshme të Shqipërisë; me shënimin: Shtetësia- Shqiptare.
2. Referuar Udhëzimit nr.13, datë 22.07.2016 *“Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2016-2017”*, në kreun IV *“Aplikimi nga kandidatë shtetas të huaj”*, në pikën 13, të tij, germa b) përcaktohet se: *“...Shtetasit e huaj dorëzojnë personalisht, ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:*

...b) Fotokopjen e dokumentit personal të identitetit”.

Theksojmë se, ankuesi bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë MAS, nuk rezulton të ketë dorëzuar një dokument ku të provojë një shtetësi tjetër, të ndryshme nga ajo shqiptare. Një dokument i tillë nuk është paraqitur nga ankuesi as pranë Komisionerit, dhe as nuk është konstatuar në dokumentacionin e këqyrur/verifikuar nga KMD gjatë inspektimit pranë MAS, dhe as gjatë komunikimit shkresor me këtë të fundit. Për rrjedhojë, Komisioneri shprehet se pretendimi i ankuesit se duhet të ishte përfshirë tek kuotat për studentët e huaj, është i pambështetur në ligj dhe i pa bazuar në prova e fakte. Argumentimi i MAS se z.D nuk mund të përfitonte nga kuotat për studentët e huaj, për sa kohë ai nuk ka provuar një shtetësi tjetër, përveç asaj shqiptare, e cila vërtetohet nga kopja e kartës së dokumentit të identifikimit të sjellë nga vetë i interesuari, është objektiv dhe i bazuar ligjërisht.

Për sa më sipër, nuk rezulton të kemi shkelje të nenit 3, pika 2 të LMD-së¹².

Komisioneri konstaton se nuk kemi shkelje të ligjit dhe as diskriminim të z.D nga ana e MAS lidhur me pretendimin e tij për përfitimin nga kuotat për studentët e huaj.

¹²Në vijim do t'i referohemi si shkurtesë për “Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi”. Neni 3, pika 2, citon se: *“Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.*

Pra, qëndrimi i MAS ka qenë i ligjshëm dhe jodiskriminues, i mbështetur në argumenta të arsyeshme dhe objektive.

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të nenit 32, gërma “c”, si dhe nenit 33, pikat 10, 11 dhe 12, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z.D. D, nga ana e MAS, lidhur me pretendimin e tij për përfshirjen në kuotat për studentët e huaj.
2. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë të z.D. D nga ana e Komisionit të Posaçëm, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, lidhur me njëvlershmërinë e diplomës së tij.
3. Ministria e Arsimit dhe Sportit, (Komisioni i Posaçëm), si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, ndaj z.D. D, rekomandohet të shqyrtojë rishtaz vendimin lidhur me njëvlershmërinë e diplomës së ankuesit.
4. MAS të realizojë zbatimin e germës e), pika 2, e kreut 3, të Udhëzimit nr.44, datë 21.08.2013 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftësive dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Ministria e Arsimit dhe Sportit, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
6. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda afateve të parashikuara në ligj.

Irma BARAKU

(shkaku: përkatësia në një grup të veçantë)
(fusha: arsim)

KOMISIONERI